



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 572/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevcu kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Arbër Rexhaj nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitura kundër vendimit me numër 860-2021 të dt.04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, lidhur me rezultatin përfundimtar të publikuar me datë 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e Panelit, të mbajtur më datë 05.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen në tërësi të bazuara apelet: Anr.572/2021, Anr.573/2021, Anr.574/2021, Anr.575/2021, Anr.576/2021, Anr.577/2021, të paraqitura nga Kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Arbër Rexhaj nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV)

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në Vendvotimet VV 2042A/27R, VV 2042A/24R, VV 2062A/01R, VV 2020A/03D, VV 2006X/03R, VV 2005X/02R,

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, me datën 04.03.2021 ka pranuar gjashtë apele nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Arbër Rexhaj nga radhët e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV, me të cilën pretendon se ka mospërputhje të gjendjes faktike të votat me votat e publikuara nga KQZ në kopjet e FRK-vë për kandidatët.

Në apelin Anr.572/2021, pretendohet se në VV 2042A/27R, pas publikimit të FRK-ve në web faqen e KQZ-se ka vërejtur mungesën e votave të tij në këtë vendvotim pasi që nuk ka përputhje mes FRK-së dhe gjendjes faktike. Si deshmë ka bashkangjitur deklaratën e Eranda Bytyyqit vezhguese e subjektit politik LVV në këtë vendnovotim, si dhe Formularin e Rezultateve të Kandidatëve nga ky vendvotim.

Në apelin Anr.573/2021, pretendohet se në VV 2042A/24R, pas publikimit të FRK-ve në web faqen e KQZ-se ka vërejtur ndërrimin e vendeve të votave mes numerit 38 numrit të tij

dhe te numrit 39. Si deshmi ka bashkangjitur deklaratën e Sahadete Kasolli vezhguese e subjektit politik LVV ne kete vendnovotim, si dhe Formularin e Rezultateve të Kandidatëve nga ky vendvotim.

Në apelin Anr.574/2021, pretendohet se në VV 2062A/01R votat e tij i janë bartur tek kandidati tjetër me numer 39 poshte tij. I njëjti thekson se kete shkelje e ka kuptuar pas publikimit FRK-ve në web faqen e KQZ-se. Si deshmi ka bashkangjitur deklaratën e Visar Xhoxhaj vezhgues i subjektit politik LVV ne kete vendnovotim, si dhe Formularin e Rezultateve të Kandidatëve nga ky vendvotim.

Në apelin Anr.575/2021, pretendohet se në VV 2020A/03D subjekti politik LVV i ka 88 vota, kurse kandidatet e parë 2/5 nuk kane asnje vote. Si deshmi ka bashkangjitur deklaratën e Leotrim Shala vezhgues i subjektit politik LVV ne kete vendnovotim, si dhe Formularin e Rezultateve të Kandidatëve nga ky vendvotim.

Në apelin Anr.576/2021, pretendohet se në VV 2006X/03R, pas publikimit të FRK-ve në web faqen e KQZ-se ka vërejtur nderrimin e e vendeve te votave mes numerit 38 numrit te tij dhe te numrit 39. Si deshmi ka bashkangjitur deklaratën e Vesa Mincit vezhguese e subjektit politik LVV ne kete vendnovotim, si dhe Formularin e Rezultateve të Kandidatëve nga ky vendvotim.

Në apelin Anr.577/2021, pretendohet se në VV 2005X/02R, pas publikimit të FRK-ve në web faqen e KQZ-se ka vërejtur rrëshqitje të rezultateve te votave ne t egjithe kandidatet ku e tij si kandidat me numer 38 janë bartur kandidatit me numrit 40. Si deshmi ka bashkangjitur deklaratën e Velson Kukit vezhgues i subjektit politik LVV ne kete vendnovotim, si dhe Formularin e Rezultateve të Kandidatëve nga ky vendvotim.

Parashtruesi i apelit në cilësinë e provave si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e vëzhguesve të subjektit politik nga vendvotimet e sipër cituara si dhe kopjet e FRK-vë, për vendvotimet e cituara si më lartë në të cilat pretendon se ka pasur parregullsi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.03.2021, të KQZ-së, ndër të tjera thekson se Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palëve ankuese, në lidhje me ankesën Anr.567/2021, njofton se Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ka përfunduar procesin e punës si dhe futjen e të dhënave, skanimin e materialeve zgjedhore, verifikimi, hetimin, e formularëve të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve, formularët e rezultateve, të kandidatëve FRK, procese këto që mundësojnë evitimin e çdo gabimi teknik dhe jo relevant. Në bazë të Rregullës Zgjedhore, Nr.06/2013, secili formular i rezultateve, para se të filloj të procedohet, i nënshtrohet procesit të auditimit në QNR, gjatë të cilit proces krahasohen votat e subjekteve me votat e kandidatëve. Nga auditimi që i është bërë formularëve të rezultateve, rezulton se ka pasur probleme, të mos shënimit të saktë në kuptimin teknik të votave të subjekteve. Kur krahasohet me votat e kandidatëve, rezulton se kandidatët kanë vota, por subjekti nuk ka vota dhe ka raste kur subjekti ka vota ndërsa kandidatët nuk kanë vota. Procedura në QNR, nuk lejon asnjë Formular të kaloj, nëse nuk përputhet me votat e subjekteve me votat e kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota atëherë formulari nuk procedohet si i rregullt dhe shkon në auditim.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, i ka bashkuar apelet e lartcekura dhe të njëjtat i trajton si një apel, të evidentuar me Anr.572/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për çka të gjitha i vendosi me një vendim për hire të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore, provave që gjinden në shkresat e lëndëve, materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuese, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në këto vendvotime si në vijim: VV 2042A/27R, VV 2042A/24R, VV 2062A/01R, VV 2020A/03D, VV 2006X/03R, VV 2005X/02R dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli, me rastin e vendosjes mori parasysh edhe pretendimet e KQZ-së, lidhur me përgjigjet në apele, mirëpo të njëjtat nuk kanë pasur ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje sepse me asnjë provë shkresore nuk e ka argumentuar dhe nuk ka ofruar prova bindëse dhe të sigurta që personeli i QNR-së, e ka kontrolluar saktësinë e të dhënave të shënuar në çdo FRK. KQZ-ja, ka për obligim ligjor dhe Kushtetues të vëzhgon të gjitha aktivitetet e zhvilluara në QNR, dhe mbanë përgjegjësi për administrimin e zgjedhjeve, gjë të cilën ka dështuar ta bëjë në këtë rast, për shkak dhe rrethana të theksuara më lartë.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 572/2021 më datën 05.03.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.